



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA KLINË
MUNICIPALITY OF KLINË
OPSTINA KLINË

Nr.No.Br. 00-13960
TOKA
Data-Date-Datum 16.04.2023

Klinë-Klinë

Memorandum Mirëkuptimi

Ky Memorandum i Mirëkuptimit është bërë më 6 prill 2023 ndërmjet komunës të Klinës dhe Organizatës Kosovare për Talent dhe Arsim-TOKA, implementuese e projektit "Let's Debate Change" me qëllim të ofrimit të sa më shumë mundësive për të rinjtë e kësaj Komune të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe aktivizimin qytetar përmes Klubeve të Debatit në shkolla.

Projekti "Let's Debate Change" i përkrahur nga organizata zvicerane Solidar Suisse do të vazhdojë të implementohet nga TOKA pas një viti të suksesshëm, në gjashtë komuna të Kosovës duke përfshirë edhe komunën e Klinës gjatë vitit 2023 dhe 2024.

Përmes pjesëmarrjes në projekt të implementuar në tri fazat e cekura më poshtë, komuna e Klinës i mundëson të rinjve të komunitetit të saj të përfitojnë si në vijim:

- Të përfitojnë nga aktivitete të edukimit jo-formal përmes takimeve javore përmes cilave të rinjtë e Komunës së Klinës do të kenë mundësi të zhvillojnë aftësi të menduarit kritik dhe kreativ.
- Të marrin pjesë aktive në identifikimin e mangësive në komunitet dhe të gjejnë zgjidhje kreative për përmirësimin e tyre - përmes komunikimit dhe bashkëpunimit me Komunën.
- Të aftësohen në praktika të debatit përmes garave lokale dhe kombëtare të debatit, duke i bërë të rinjtë më të sigurt në argumentim dhe të folur publik.
- Të përfitojnë nga kampet verore të Debatit dhe Lidershipit pa pagesë, përmes të cilave do të aftësohen në debatim dhe shkathtësi të lidershipit.
- Të marrin rolin e Liderëve të Rinj dhe të udhëheqin sesione në takimet javore të Klubeve të Debatit duke thelluar aftësitë e planifikimit dhe fascilitimit.
- Të përfitojnë nga aktivitete të njoftes së hapave të një projekti duke përfshirë dhe planifikimin e buxhetit, përmes planifikimit dhe zbatimit të një projekti në komunën tuaj.

Fazat e Projektit "Let's Debate Change" gjatë vitit 2023 dhe 2024 do të janë:

Faza 1: Ngritje e kapaciteteve të nxënësve pjesëmarrës në shkolla përmes Klubeve të Debatit - PRANVERË (mars-qershori 2023 dhe mars-qershori 2024)

Kjo do të bëhet përmes rifillimit të takimeve javore në dy shkolla të mesme të larta në secilën prej komunave pjesëmarrëse gjatë muajve mars-qershori të viteve 2023 dhe 2024. Këto takime do të udhëheqen nga Liderë të Rinj të Klubeve të Debatit nga shkollat përkatëse, me mbështetjen e edukatorëve me përvjohje nga TOKA. Si rezultat, Klubet do të mund të takohen me përfaqësuesit e tyre komunal dhe të dorëzojnë Dokumentin me Rekomandime për përmirësimë në komunitet - të rishikuar nga viti i kaluar. Po ashtu përgjatë kësaj kohe nxënësit do të organizojnë gara të Debatit në nivel të shkollës dhe të komunës.

Faza 2: Ngritje e kapaciteteve të nxënësve në nivel kombëtar - VERË (qershori-shtator 2023 dhe qershori-shtator 2024)

Kjo do të bëhet përmes kampeve verore rezidenciale gjatë periudhës qershori-shtator 2023 dhe qershori-shtator 2024. Nxënësve më të motivuar të komunave të përfshira do t'ju jepet mundësia për pjesëmarrje falas në Kampin e Debatit dhe atij të Lidershipit. Si rezultat, pjesëmarrësit e Klubeve do të ngrisin edhe më tej kapacitetet e tyre për aktivizim qytetar, shkathtësitë e udhëheqjes dhe shkathtësi të debatit.

Faza 3: Zbatimi i projekteve lokale në komunitet nga nxënësit e shkollave - VJESHTË (shtator-nëntor 2023 dhe shtator-nëntor 2024)

Me fillimin e vitit të ri shkollor 2023/2024 dhe më pas 2024/2025, Klubet e Debatit do të rikthehen në shkolla me fokus zbatimin e projekteve që kanë për qëllimin përmirësimin e komunitetit. Synimi ynë është që takimet e Klubeve do të bashkë-udhëhiqen nga pjesëmarrësit e Klubeve të Debatit të trajnuar gjatë kampeve verore, me mbështetjen e Liderëve të Rinj të gjeneratës 2022 dhe të edukatorëve të TOKAs. Ndërsa, planifikimi, zbatimi dhe inaugurimi i projekteve do të bëhet në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe drejtori të shkollave pjesëmarrëse gjatë periudhës shtator-nëntor 2023 dhe shtator-nëntor 2024. Në këtë fazë, nxënësit do të takohen të paktën dy herë me përfaqësuesit e tyre komunalë.

Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit

Komuna e Klinës dhe Organizata Kosovare për Talent dhe Arsimit-TOKA, së bashku janë referuar në këtë dokument si "palë" dhe me këtë Memorandum Mirëkuptimi bien dakord për të filluar partneritet në zhvillimin dhe realizimin e projekteve që do të mbështesin dhe përmirësojnë nxënien, aftësimin dhe aktivizimin e rinisë përmes Klubeve të Debatit të shkollave në këtë Komunë.

Përgjegjësítë e Palëve

Përgjegjësítë specifike në përputhje me synimin e këtij Memorandumi janë:

Përgjegjësítë e TOKAs

- a) Ofrimi i trajnimeve, monitorimit, programit të aktiviteteve, asistencës teknike dhe financiare bazike për projektet e nxënësve vullnetarë në Klubet e Debatit, duke përfshirë materialet për Klubet e Debatit;
- b) Promovimi i punës dhe projekteve të Klubeve të Debatit, duke përfshirë edhe materialin e gatshëm për Komunën që ta promovojë në rrjetet e saj mediale;
- c) Sigurimi i programit dhe mjetet e tjera të nevojshme për Klubet e Debatit me qëllim identifikimin e nevojave në komunitet, të cilat adresohen nga pjesëmarrësit e Klubeve përmes projekteve vullnetare, mirëpo pa imponuar në përzgjedhjen e ideve specifike;
- d) Përditësimi i Drejtorisë Komunale të Arsimit me të dhëna rreth të mbarëvajtjes së aktiviteteve të Klubeve të Debatit, përmes takimeve vjetore të raportimit dhe përmes komunikimit medial;
- e) Siguron Komunën që aktivitetet dhe temat e debatit në kuadër të projektit "Let's Debate Change" me nxënës dhe në shkolla do të janë gjithëpërfshirëse dhe nuk do të kenë anime apo ngjyrime fetare apo partiake;
- f) Mbështetë financierisht projektet e Klubeve të Debatit për komunitetin, përmes shumës së buxhetuar 300 euro bruto për projekt në komunë - i dizajnuar nga dy Klubet e Debatit;
- g) Përzgjedh, komunikon dhe menaxhon nxënës të Klubeve të Debatit për të marrë pjesë në kampet e verës dhe i trajnon ata për të marrë përsipër rolin e Liderit/ës të Ri/e në vjeshtë të çdo viti përkatës;
- h) Njofton dhe koordinon nxënësit në bashkëpunim me zyren e Solidar Suisse Kosova për të marrë pjesë në eventet publike të Komunës, duke përfshirë prezantimin e Dokumenteve të Rekomandimeve.

Përgjegjësítë e Komunës

- a. I mundëson stafit të TOKAs qasje në shkollat e mesme të larta Shkollën e Mesme Teknike "Fehmi Agani" dhe Gjimnazi "Luigj Gurakuqi" për realizim të projektit dhe aktiviteteve me Klubet e Debatit;

- b. Promovon dhe inkurajon shkollat relevante në Komunë për të marrë pjesë në projektin "Let's Debate Change" nga TOKA;
- c. Promovon përmes mediave sociale punën e Klubeve te Debatit në Komunë;
- d. Viziton dhe promovon projektet e përfunduara të Klubeve në Komunë;
- e. Ndanë mirënjojje për liderët e Klubet e Debatit dhe përkrahësit e projekteve rimore në Komunë, sipas propozimeve të TOKAs;
- f. Mbështetë finansiarisht aktivitetet e Klubeve në vlerë prej minimum 200 euro, por me mundësi te rrjetes se vlerës në vit, përvitjet 2023 dhe 2024. Duke participuar këshu në përkrahjen e projekteve të Klubeve të Debatit për komunitetin. Këto fonde do të transferohen në xhirologari të TOKA-s më së largu deri më 30 shtator të vitit përkatës;
- g. Mbështetë teknikisht Klubet e Debatit duke siguruar ushqim, transport dhe nevoja të tjera për pjesëmarrësit e Klubeve të Debatit përgjatë fazave 1, 2, dhe 3;
- h. Siguron dhe lehtëson procesin e marrjes së lejeve për shfrytëzimin e hapësirave në Komunë dhe në shkollat pjesëmarrëse në projekt, përmajtjen e takimeve të Klubeve të Debatit; apo duke i ofruar Klubeve qasje në hapësira publike përmajtje të takimeve si Qendra Rinore, hapësira të tjera në komunë, sipas nevojës;
- i. Ndhimon organizatën TOKA në vendosjen e bashkëpunimit me palët e interesit, siç janë: Kuvendi Komunal, zyrtarët komunal për arsim, rini, dhe kulturë, drejtoret e shkollave, koordinatorët e cilësisë, mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit e tyre;
- j. Mundëson pjesëmarrjen e nxënësve të Klubeve të Debatit në mbledhje të Kuvendit Komunal (së paku dy në vit) me qëllim të përfitimit të praktikave debatuese dhe politikëbërëse në Komunë;
- k. Mundëson takime në mes të pjesëmarrësve të Klubeve të Debatit dhe të drejtorisë së shkollave pjesëmarrëse gjatë identifikimit dhe planifikimit të idesë së projektit komunitar me qëllim të përfitimit të shkollës dhe nxënësve të saj;
- l. Mundëson takim në mes të Kryetarit të Komunës dhe të Klubeve të Debatit të shkollave së paku një herë në vit përmajtje të cilët janë përgjegjës përmes nevojës;
- m. Mbështetë në mënyra të tjera, sipas nevojës dhe mundësisë, Klubet e Debatit në Komunë.

Procesi i transferimit të fondeve të zotuara në këtë Memorandum Mirëkuptimi

- a. TOKA zotohet të shfrytëzoj fondet e zotuara nga Komuna vetëm për nevojat e projekteve te propozuara nga Klubet të Debatit në Komunën e Klinës, ashtu siç është e specifikuar në këtë Marrëveshje;
- b. TOKA do të sigurohet të përcjellë tek Komuna e Klinës dokumentet e nevojshme për transferimin e fondeve të zotuara nga Komuna, duke përfshirë Certifikatën e Regjistrimit si OJQ, Po ashtu TOKA zotohet të mbështhesë Komunën në këtë proces, përmes informatave dhe dokumenteve shtesë, si dhe përmes koordinimit me Zyrën e Financave, sipas nevojës.
- c. Komuna e Klinës do të transferoj shumën minimale 200 euro, por nëse mundësia financiare lejojnë komunën mund të transferoj vlera më të mëdha, në xhirologarinë e TOKA-s, duke respektuar afatin e caktuar në këtë Memorandum.
- d. TOKA zotohet që fondet e transferuara nga komuna t'i kalojë tek edukatorët e Klubeve të Debatit, të cilët janë përgjegjës përmajtje të cilët janë përgjegjës përmes nevojës;
- e. TOKA do të përgatisë raport narrativ dhe financiar për Komunën, në të cilën do të cekën aktivitetet e përfunduara me fondet e Komunës të bashkangjitur me një tabelë të shpenzimeve të evidentuara me raport të transferimit të fondeve tek edukatorët e Klubeve dhe fatura të shpenzimeve. Ky raport do të dorëzohet më së largu 30 ditë nga përfundimi i zbatimit të projektit vullnetar të Klubeve.

MEMORANDUM

Çdo komunikim lidhur me realizimin e projektit "Let's Debate Change" do të bëhet përmes personave kontaktues të OJQ TOKA: Erzë Salihu, erze@toka-ks.org, +383 49 579 824 dhe përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit në Komunë: Qemajl Sejdija, qemajl.sejdija@rks-gov.net, 046933339.

Data e hyrjes në fuqi

Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Palët dhe do të ekzekutohet deri me 31 dhjetor 2024.

Klinë, 6 prill 2023


Komuna e Klinës



Zenun Elezaj
Kryetar



Organizata Kosovare për Talent dhe Arsim -
TOKA



Jehona Gjurgeala
Drejtore Ekzekutive